




RAPORTET BILATERALE TREGTARE
NDËRMJET *KOSOVËS* DHE *SERBISË*
ME THEKS TË VEÇANTË NË MARRËVESHJEN E
TREGTISË SË LIRË TË *EVROPËS QENDRORE (CEFTA)*

Tetor 2019

Mbështetur nga:



Norwegian Embassy





Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: ridea-ks.org

STUDIM

MBI

RAPORTET BILATERALE TREGTARE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË ME THEKS TË VEÇANTË NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE (CEFTA)

Tetor 2019

STUDIM
MBI
RAPORTET BILATERALE TREGTARE NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË ME THEKS TË VEÇANTË NË
MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS
QENDRORE (CEFTA)

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| Shkurtesat..... | i |
| Hyrje..... | 1 |
| Shpallja e Pavarësisë dhe Raportet Tregtare Bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë 2008-2010..... | 2 |
| Dialogu i Brukselit dhe Raportet Tregtare Bilateral në mes të Kosovës dhe Serbisë 2011-2018..... | 8 |
| Tarifa Doganore 100 % dhe Raportet Tregtare Bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë 2019 | 15 |
| Rekomandimet | 20 |
| Shtojca | 26 |
| Shtojca 1. Barrierat Jo-Tarifore, Barrierat Teknike dhe Standardet/Masat Sanitare dhe Fitosanitare të Imponuara nga Serbia ndaj Republikës së Kosovës | 26 |

Shkurtesat

| | |
|--------------|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| BeH | Bosnja dhe Hercegovina |
| CEFTA | Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore |
| EJL | Evropa Juglindore |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit |
| GjND | Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë |
| KBR | Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal |
| KE | Komisioni Evropian |
| KS | Këshilli i Sigurimit |
| MIK | Menaxhimi i Integruar i Kufirit |
| MSA | Marrëveshja për Stabilizim Asociim |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior |
| PS | Pakti i Stabilitetit |
| PSSP | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm |
| ROSU | Njësia Speciale Rajonale e Operacioneve |
| TVSH | Tatimi në Vlerën e Shtuar |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| UNMIK | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |

Hyrje

1. Qëllimi i këtij punimi është që të analizohen në mënyrë kritike raportet tregtare bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke u fokusuar në marrëveshjen CEFTA.
2. Objektivat e këtij punimi janë:
 - i) Rishikimi kritik i faktorëve historik mbi raportet tregtare bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë;
 - ii) Rishikimi kritik i implikimeve ligjore dhe ekonomike i anëtarësimit në CEFTA për Kosovën;
 - iii) Rishikimi kritik i aspekteve ligjore dhe ekonomike të raporteve tregtare në mes të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të CEFTA;
 - iv) Rishikimi kritik i aktiviteteve të ndërmarra deri më tani nga Kosova si kundërpërgjigje ndaj shkeljeve të vazhdueshme të CEFTA nga ana e Serbisë;
 - v) Rishikimi kritik i ndikimit në importet e Kosovës që rezultojnë nga shkeljet e CEFTA nga ana e Serbisë; dhe
 - vi) Propozimi i rekomandimeve politike.

Struktura e këtij punimi bazohet në rrjedhën kronologjike të ngjarjeve që kanë ndodhur në raportet tregtare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Shpallja e Pavarësisë dhe Raportet Tregtare Bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë 2008-2010

1. Në vitin 2008, Parlamenti i Kosovës shpalli Kosovën vend të pavarur dhe sovran. Deri më tani Kosova është njohur nga 116 shtete. Kuvendi i Serbisë i cili edhe më tutje e konsideron Kosovën si pjesë të territorit të saj sovran, u shpreh se Deklarata e Pavarësisë e shpallur nga Kuvendi i Kosovës është joligjore nën arsyetimin se “nuk ishte në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, kushtetutën e Serbisë, Aktin Final të Helsinkit, Rezolutën 1244 (duke përfshirë këtu edhe rezolutat e mëparshme) dhe Komisionin e Badinterit”. Duke kërkuar mbështetje për qëndrimin e saj, Serbia inicoi një kërkesë të drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi (GJND) për mendim këshillëdhënës mbi ligjshmërinë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. GJND shprehu se *“miratimi i deklaratës së pavarësisë të datës 17 Shkurt 2008 nuk ka shkelur ligjin e përgjithshëm ndërkombëtar, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit apo Kornizën Kushtetuese. Rrjedhimisht, miratimi i kësaj deklarate nuk përbën shkelje të asnjë rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare”*.¹
2. Pas vendimit të GJND-së, të datës 22 korrik 2010², Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë të hartuar bashkërisht nga Bashkimi Evropian dhe Serbia që përmban një kërkesë për një dialog të lehtësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë i cili do të “ ishte një faktor për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon, dhe se ai dialog do të promovonte bashkëpunimin, arritjen e përparimit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe të përmirësonte jetët e njerëzve”.³

¹ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (2010), ‘Përputhja me Ligjin Ndërkombëtar e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në Lidhje me Kosovën’. Në dispozicion në: <https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

² Po aty.

³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2010), ‘Rezoluta 64/298’. Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/Documents/GA64298.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

3. Me Shpalljen e Pavarësisë, edhe pse situata e sigurisë konsiderohej relativisht stabile, dy incidente ndodhën në veri të Kosovës. Serbët lokalë me përkrahjen e Beogradit i vunë zjarrin dhe shkatërruan dy pika kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë (Bërnjak dhe Jarinje). Një muaj më vonë, serbët lokalë hynë me dhunë në ndërtesën e gjykatës në Mitrovicë, gjë që çoi në përleshjen midis tyre dhe policisë së UNMIK-ut. Si pasojë e kësaj, një polic i UNMIK-ut humbi jetën dhe shumë të tjerë u plagosën rëndë. Sipas serbëve lokalë, arsyeja kryesore pse ata shkaktuan këto dy incidente ishte se ata refuzonin të jetonin në një Kosovë të pavarur dhe refuzonin t’ia paguanin TVSH buxhetit të një Kosove të pavarur.⁴

4. Reagimi i qeverisë së Serbisë lidhur me raportet tregtare me Kosovën ishte i menjëhershëm. Serbia vendosi që të aplikojë lirim nga tatimi për bizneset serbe, të cilat eksportonin produktet në pjesën veriore të Kosovës. Rrjedhimisht, bizneset e Serbisë nuk paguan TVSH as në Serbi as në Kosovë. Kjo çoi në përforcimin e mëtejshëm të “zonës së tregtisë së lirë”, e cila de facto (por jo de jure) ekzistonte në veri të Kosovës. Ky vendim i Serbisë dhe roli i saj përkrahës në incidentet në pikat kufitare paraqitnin një shkelje të drejtpërdrejt të pushtetit të Kosovës mbi shërbimin doganor dhe shkelje të CEFTA-s.

5. Më 9 prill 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila parashihte një rol të rëndësishëm për BE-në në Kosovë. Në korrik 2008, UNMIK u urdhërua nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (UNSG) që të bashkëpunojë me BE-në dhe të marrë një rol më shumë operacional lidhur me sundimin e ligjit nën ombrellën e OKB-së. Kjo nënkuptonte rikonfigurimin e misionit të UNMIK-ut. Kosova themeloi Shërbimin Doganor të Kosovës dhe kështu mori nga UNMIK-u pushtetin edhe në atë sektor dhe zëvendësoi të gjitha simbolet e UNMIK-ut me simbole të Kosovës. Po ashtu, Kosova zëvendësoi vulat e doganave të UNMIK-ut me vulat e Doganave të Kosovës që përmbanin simbolet shtetërore të Kosovës.

⁴ Kursani dhe Thaqi (2015), ‘Rregullimi i tregtisë ndërmjet kufijve të kontestuar. Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros’. Në dispozicion në: https://www.international-alert.org/sites/default/files/Caucasus_RegulationOfTradeAcrossBorders_EN_2015.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

Shërbimi Doganor i Kosovës filloi të administrojë edhe pikat kufitare. Mirëpo, sipas Planit Gjashtë Pikësh të OKB të vitit 2008, ishte misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX) ai që kishte mandatin për të administruar me dy pikat kufitare në veriun e Kosovës. Gjithashtu, sipas këtij plani, të hyrat doganore të mbledhura në këto dy pika kufitare duhej të shfrytëzoheshin për zhvillimin e komuniteteve lokale në pjesën veriore të vendit.

6. Në bazë të Rezolutës 1244, UNMIK-u do të administronte përkohësisht në Kosovë dhe mision kishte ushtrimin e sovranitetit në tërë territorin e Kosovës. Prandaj, në emër të Kosovës UNMIK ishte nënshkruar në një mori organizatash dhe marrëveshjesh ndërkombëtare, duke përfshirë këtu CEFTA-n. Megjithatë, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ishin autoritetet e Kosovës ato që duhej të siguronin përfaqësimin rajonal dhe ndërkombëtar të Kosovës. Rikonfigurimi i UNMIK-ut parashihte që UNMIK të lehtësonte, kudo që ishte e nevojshme dhe e mundur, aranzhimet për angazhimin e Kosovës në marrëveshjet ndërkombëtare. Fatkeqësisht, disa nënshkruar të marrëveshjeve ndërkombëtare refuzonin të pranonin autoritetet e Kosovës si pasardhës të UNMIK-ut.⁵ Në këtë drejtim, pavarësisht nga realiteti i ri institucional në Kosovë dhe nga rikonfigurimi i UNMIK-ut, për shkak të insistimit të Serbisë dhe BeH, UNMIK vazhdoi të përfaqësojë Kosovën në të gjitha takimet e CEFTA-s. Përveç ndryshimit të vulave dhe dokumenteve doganore, Kosova nuk ndërmori asnjë masë konkrete për të marrë nga UNMIK autoritetin e plotë, në mënyrë që në CEFTA të përfaqësojë veten si një shtet i pavarur dhe me emrin e vet kushtetues “Republika e Kosovës”.
7. Më 4 dhjetor 2008, edhe pse Kosova u përfaqësua nga UNMIK në CEFTA, Serbia dhe BeH vendosën të bllokojnë të gjitha produktet që eksportoheshin nga Republika e Kosovës në Serbi dhe produktet në tranzit që eksportoheshin apo importoheshin nga Kosova (dhe kështu duhej të përdornin Serbinë si vend tranzit). Kjo bëhej nën

⁵ Komisioni Evropian (2008), ‘Raporti i progresit të Kosovës* 2008’. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/press_corner/key-documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

arsyetimin se zëvendësimi i dokumenteve dhe vulave të UNMIK-ut me dokumente dhe vula që përmbanin simbole shtetërore të Kosovës ishte shkelje e Rezolutës 1244 dhe e CEFTA-s. Bllokada vazhdoi, pavarësisht nga “garantimi/sigurimi i ofruar nga PSSP i OKB-së që konfirmonte përputhjen e tyre [vulave dhe dokumenteve të Kosovës] me rezolutën 1244/99” të KS të OKB-së.⁶ Për shkak të bllokadës bizneset kosovare të shqiptarëve u detyruan të eksportonin produktet e tyre në Serbi në formën e ri-eksporteve përmes vendeve të treta ose të gjenin tregje të reja për eksport dhe duhej të përdornin vende tjera për tranzit. Kjo ndikoi në rritjen e kostove të transaksionit për eksport (monetare, procedurale dhe kostove të ndërlidhura me kohën). Bizneseve kosovare të serbëve, në anën tjetër, iu lëshuan dokumente nga Administrata Tatimore e Serbisë, e cila jashtëligjshëm operonte në pjesën veriore të Kosovës. Serbia e vlerësonte këtë tregti si tregti interne dhe jo si eksport. Përmes këtyre aktiviteteve, Serbia sërish shkeli CEFTA-n në disa pika: (i) Serbia ndaloi së pranuari Kosovën si territor doganor të pavarur (një obligim ligjor që kishte marrë Serbia në momentin që u bë nënshkruese e CEFTA-s), (ii) Serbia shkeli pushtetin e Kosovës mbi shërbimin doganor (duke interferuar me pushtetin e institucioneve të Kosovës përmes lëshimit të dokumenteve të Serbisë) dhe (iii) përveç shkeljes së CEFTA-s në terma të përgjithshëm, Serbia specifikisht shkeli Nenin 8 të CEFTA-s mbi “Kufizimet sasiore të importeve dhe masat që kanë ndikim të barasvlefshëm”.

Tabela 1. Eksportet, Importet, Bilanci Tregtar dhe Raporti i Eksporteve ndaj Importeve në mes të KOSOVËS dhe Serbisë, 2008-2010

| | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|----------------------------|--------|--------|--------|-------|--------|--------|
| Importet (në mil €) | 152.3 | 191.1 | 222.5 | 208.9 | 211.1 | 260.5 |
| Eksportet (në mil €) | 8.2 | 20.9 | 19.3 | 9.9 | 3.5 | 3.9 |
| Bilanci tregtar (në mil €) | -144.1 | -170.2 | -203.2 | -199 | -207.6 | -256.6 |

⁶ Komisioni Evropian (2010), ‘Raporti i progresit të Kosovës* 2010’ fq. 33. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

| | | | | | | |
|---|------|-------|------|------|------|------|
| Raporti i eksporteve ndaj importeve (në %) | 5.38 | 10.94 | 8.67 | 4.74 | 1.66 | 1.50 |
|---|------|-------|------|------|------|------|

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës (2019)

8. Embargoja e vënë nga Serbia dhe BeH ndaj Republikës së Kosovës në vitin 2008 kishte ndikim të thellë në eksportet e Kosovës drejt këtyre dy vendeve. Sipas Tabelës 1, në vitin 2008, vlera e eksporteve u përgjysmua krahasuar me vitin paraprak. Me vazhdimin e bllokadës së Serbisë ndaj eksporteve të Kosovës, përkundër përpjekjeve të Kosovës për të gjetur një zgjidhje për mosmarrëveshjen tregtare, eksportet e Kosovës vazhduan të zvogëloheshin në vitet në vijim duke rënë në një vlerë prej më pak se 4 milion € në vit; vlerë kjo katër herë me vogël se vlera e eksporteve të regjistruara në vitin 2007. Për më shumë, raporti në mes të eksporteve dhe importeve ra në rreth 1 përqind gjatë periudhës 2009-2010.
9. Në bazë të Nenit 34 të CEFTA-s, Këshilli i Përbashkët duhet të themelohet në përbërje të përfaqësuesve (ministrat përkatës) të vendeve nënshkruese. Ky këshill ka përgjegjësinë për të mbikqyrur dhe administruar implementimin e CEFTA-s, dhe sipas Nenit 35 këshilli duhet të mbledhet së paku një herë në vit dhe sipas nevojës me kërkesën e cilësdo Palë (nënshkruesi) të CEFTA. Për aktivitetet e këshillit marrëveshja e përbashkët e nënshkruesve është obligative. Me Vendimin Nr.1/2007 të Këshillit të Përbashkët⁷, u themelua Sekretariati i Përhershëm që ka si mandat përkrahjen e punës së këshillit. Neni 34, Paragrafi 3, parasheh që nënshkruesit “duhet të këmbëjnë informata dhe, me kërkesën e cilësdo Palë, duhet të mbajnë këshillime në kuadër të Këshillit të Përbashkët. Këshilli duhet të rishikojë mundësinë e heqjes shtesë të pengesave tregtare në mes të palëve”.⁸ Gjithashtu, sipas Nenit 42, në rast të mosmarrëveshjeve “Palët duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që përmes bashkëpunimit dhe këshillimeve, nëse është e nevojshme në kuadër të Këshillit të Përbashkët, të arrijnë te një zgjidhje reciprokisht të

⁷ CEFTA (2007), ‘Vendimi Nr.1/2007 Rregullat dhe Procedurat e Komitetit të Përbashkët’. Në dispozicion në: <http://cefta.int/legal-documents/#1463498451954-049a1331-0c1c> [Qasur më: 31 gusht 2019].

⁸ CEFTA (2007), ‘Shtojca 1 e Marrëveshjes për Ndryshimin dhe Hyrjen në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore’. Në dispozicion në: <http://cefta.int/wp-content/uploads/2016/05/ANN1CEFTA-2006-Final-Text.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

kënaqshme”.⁹ Në të kundërtën, sipas po këtij neni, pala e dëmtuar duhet t’i ofrojë informata Këshillit të Përbashkët, i cili më pas duhet të rekomandojë masat e përshtatshme, ose duhet të caktohet një ndërmjetësues për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Në rast se dështon ndërmjetësimi, sërish Këshilli i Përbashkët duhet të rekomandojë masa të përshtatshme. Sipas nenit 42, Paragrafi 3 i CEFTA, nëse përpjekjet e lartpërmendura për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjegjësisht këshillimet në mes të Palëve ose ndërmjetësimi në kuadër të Këshillit të Përbashkët, dështojnë “në arritjen e një zgjidhjeje përgjithësisht të pranueshme brenda 90 ditëve kalendarike nga data e pranimit të lajmërimit, të cilit i referohet paragrafi 2, Pala në fjalë mund të ndërmarrë masa të përkohshme ribalancuese (reciproke) nën kushtet dhe në përputhje me procedurat e paraqitura në Nenin 24.” Në rast të masave ribalancuese, Palët në fjalë dhe Këshilli i Përbashkët “duhet të mbajnë këshillime të rregullta me qëllim të shfuqizimit të tyre. Masat duhet të shfuqizohen kur rrethanat/kushtet nuk arsyetojnë më mbajtjen e tyre sipas Këshillit të Përbashkët, ose nëse mosmarrëveshja dorëzohet në arbitrazh...” Po ashtu, nëse të gjitha përpjekjet e parapara për zgjidhje dështojnë, mosmarrëveshja mund të dorëzohet nga Pala e dëmtuar në tribunalin e arbitrazhit.¹⁰ Nga e tërë kjo shihet se CEFTA-s i mungon një mekanizëm i definuar në mënyrë të qartë, efektiv dhe i pavarur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo ka penguar funksionimin e mirëfilltë të CEFTA-s dhe ka krijuar stimuj për nënshkruesit që të shkelin atë, posaçërisht Serbinë në raport me Republikën e Kosovës.

10. Autoritetet e Kosovës kanë raportuar dhe janë ankuar disa herë tek autoritetet e Serbisë, BE-së dhe Sekretariatit të Këshillit të përbashkët për shkeljet e vazhdueshme të CEFTA-s nga ana e Serbisë dhe BeH-së, veçanërisht për atë të vitit 2008 lidhur me embargon e Serbisë dhe BeH-së ndaj eksporteve të Kosovës dhe produkteve në tranzit përgjatë territoreve të tyre. Përkundër kësaj, nuk ka pasur

⁹ CEFTA (2007), ‘Vendimi i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore Nr. 1/2007 - Neni 42.1’. Në dispozicion në: <http://cefta.int/legal-documents/#1463498451954-049a1331-0c1c> [Qasur më: 31 gusht 2019].

¹⁰ CEFTA (2007), ‘Vendimi i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore Nr. 1/2007 - Neni 43’. Në dispozicion në: <http://cefta.int/legal-documents/#1463498451954-049a1331-0c1c> [Qasur më: 31 gusht 2019].

përpyekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes përmes konsultimeve në kuadër të Këshillit të Përbashkët. Si rezultat, mosmarrëveshja mbeti e pazgjidhur.¹¹ Serbia dhe BeH vazhduan me shkeljet e CEFTA-s në kuptimin e tregtisë me Kosovën, përderisa Kosova vazhdoi të importojë nga këto dy shtete pa aplikuar asnjë kufizim apo masa reciprociteti.

Dialogu i Brukselit dhe Raportet Tregtare Bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë 2011-2018

11. Në bazë të Rezolutës së vitit 2010 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në mars 2011 filloi dialogu në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE, i cili përmbante çështje edhe teknike edhe politike.¹² Dialogu që u përkrah fuqimisht nga SHBA kishte për qëllim “të promovonte bashkëpunimin, arritjen e përparimit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe të përmirësonte jetët e njerëzve.”¹³

12. Në raundin e gjashtë të negociatave, të planifikuara për korrik 2011, Kosova dhe Serbia supozohej se do të zgjidhnin, ndër të tjera, mosmarrëveshjet lidhur me mospranimin nga ana e Serbisë të vulave të doganave të Kosovës. Ky takim u anulua nga ndërmjetësuesi, z. Cooper nën arsyetimin se “asnjë marrëveshje nuk do të mund të arrihej”, pasi që Serbia e kishte informuar atë me shkrim se nuk ishte e gatshme të merrte pjesë. Ngurrimi i Serbisë për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje u nxit nga interesi i saj për të ruajtur status quo-në në veriun e Kosovës, si mënyrë për të siguruar ndikimin e saj në Kosovë (gjegjësisht shkeljen e sovranitetit të Kosovës).

¹¹ Intervista me zyrtar relevant në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

¹² Parlamenti i Kosovës (2012), ‘Rezoluta për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë’. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Resolution_on_normalization_of_relationships_between_Republic_of_Kosovo_and_Republic_of_Serbia_18102012.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

¹³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2010), ‘Rezoluta 64/298 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme’. Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/Documents/GA64298.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

13. Më 20 korrik 2011, duke marrë parasysh që këshillimet bilaterale, Këshilli i Përbashkët dhe dialogu i lehtësuar nga BE dështuan që të gjejnë një zgjidhje për mosmarrëveshjen tregtare, qeveria e Kosovës vendosi të aplikojë masa reciprociteti dhe kështu aplikoi embargo ndaj importeve nga Serbia dhe BeH. Në bazë të Nenit 42, Paragrafi 3 i CEFTA, institucionet e Kosovës kishin të drejtë të plotë të aplikonin masa reciprociteti kundër Serbisë dhe BeH.

14. Parakusht për qeverinë e Kosovës që në mënyrë efektive dhe efikase t'i zbatonte masat e reciprocitetit ishte parandalimi i tregtisë ilegale në (de facto por jo de jure) zonën e tregtisë së lirë në veriun e vendit. Meqë dy pikat kufitare në veriun e vendit (Bërnjak dhe Jarinje) ishin ekskluzivisht nën autoritetin e EULEX-it, qeveria e Kosovës kërkoi nga i njëjti që në mënyrë efektive të zbatonte vendimin qeveritar mbi masat e reciprocitetit. Megjithatë, EULEX refuzoi një gjë të tillë. Si pasojë, më 25 korrik 2011 Qeveria e Kosovës vendosi të dërgojë Njësinë Speciale për Operacione Rajonale (ROSU) për të zbatuar embargo në dy pikat kufitare në veri të vendit.¹⁴ Serbët lokalë, të përkrahur nga Serbia përmes strukturave paralele, reagueshan duke bllokuar rrugët dhe duke shtënë me armë zjarri mbi njësinë ROSU. Kjo çoi në përleshjen e serbëve me ROSU dhe KFOR. Situata eskaloj dhe si rezultat u vra një anëtar i ROSU-s. Menjëherë më pas, u rikthye rendi dhe situata e sigurisë u vu nën kontrollin e KFOR-it. Përkundër kësaj, grupet kriminale të serbëve lokalë shkatërruan njërin nga pikëkalimet kufitare. Trupat e KFOR-it intervenuan dhe parandaluan përkeqësimin e mëtejshëm të situatës. Ndërkohë, Serbia vazhdoi me angazhimin e saj destruktiv në veriun e Kosovës, duke dërguar negociatorin e saj për t'u takuar me serbët lokalë dhe për t'i nxitur të njëjtit që t'i rezistojnë vendosjes së pushtetit të institucioneve të Kosovës në veriun e vendit.

15. Deri në shtator 2011, dy pikat kufitare mbetën nën kontrollin e KFOR-it. Një regjim tregtar i posaçëm u aplikua, me ç' rast "nuk u mblodhën të hyra doganore dhe

¹⁴ GPLS (2013), 'Dialogu Kosovë-Serbi: Dritaret e Mundësisë apo një Shtëpi Kartash? Analiza e Politikave'. Në dispozicion në: <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2013/03/KOSOVO%E2%80%93SERBIA-DIALOGUE-Windows-of-Opportunity-or-a-House-of-Cards.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

produktet që duhej t'i nënshtroheshin akcizës dhe kontroleve sanitare dhe fitosanitare nuk u lejuan të hynin përmes këtyre dy pikëkalimeve kufitare”.¹⁵ Doganat e Kosovës vërtetonin/validonin certifikatat e origjinës për produktet e eksportit për tërë territorin e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe veriun e vendit. Gjithsesi, për shkak të barrikadave rrugore të krijuara nga serbët lokalë ishte pothuajse e pamundur që zyrtarët e Doganave të Kosovës t'i qaseshin pjesës veriore të territorit të Kosovës. Po ashtu, për shkak të mbikëqyrjes joefikase doganore, ekonomia informale vazhdoi.

16. BE vetëm nxiti Kosovën dhe Serbinë që të vazhdojnë dialogun e lehtësuar nga BE, në mënyrë që të zgjidhin mosmarrëveshjen dhe të parandalojnë eskalimin e mëtejme të situatës.¹⁶

17. Në shtator 2011, dialogu i lehtësuar nga BE në mes të Kosovës dhe Serbisë vazhdoi, ku edhe u negociua marrëveshja për doganat. Kosova largoi stemën shtetërore dhe fjalën Republikë nga vulat doganore, gjë që u pranua nga Serbia. Si rezultat, të dy vendet i dhanë fund embargove tregtare dhe kështu vazhdoi lëvizja e mallrave. EULEX, dhe jo Doganat e Kosovës, vazhduan të ushtrojnë pushtetin ekzekutiv mbi dy pikat kufitare në fjalë. Përkundër marrëveshjes, serbët lokalë vazhduan të shprehin mospërfilljen e tyre duke krijuar bllokada të reja, si rezultat i të cilave zyrtarët e Doganave të Kosovës mundën t'i qasen dy pikave kufitare në veri vetëm përmes helikopterëve.

18. Për Kosovën ishte jetësore që të zbatohet një shërbim doganor i unifikuar dhe të konfirmohet sovraniteti i saj në tërë territorin e saj. Në dhjetor 2011, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen mbi

¹⁵ Komisioni Evropian (2011), 'Raporti i progresit të Kosovës* 2011'. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

¹⁶ ReliefWeb (2011), 'Deklaratë e Përfaqësueses së Lartë Catherine Ashton për situatën në veri të Kosovës'. Në dispozicion në: <https://reliefweb.int/report/serbia/statement-high-representative-catherine-ashton-situation-north-kosovo> [Qasur më: 31 gusht 2019].

Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK). Sipas kësaj marrëveshje, duhej të themeloheshin gjashtë pika kufitare të përkohshme në mes të dy vendeve. Një pikë kufitare duhej të “drejtohej nga një zyrtar i BE-së, një i Serbisë dhe një zyrtar nga Kosova”.¹⁷ Rrjedhimisht, EULEX do të vazhdonte të ushtronte pushtetin ekzekutiv mbi pikat kufitare në Jarinje dhe Bërnjak, përderisa zyrtarët e Kosovës dhe të Serbisë do të kishin rolin e vëzhguesve. Parakusht për zbatimin e Marrëveshjes MIK të 2011 ishte që Kosova dhe Serbia të nënshkruajnë Protokolin Teknik mbi MIK. Ky veprim u vonua nga Serbia për më shumë se një vit.¹⁸ Në vitin 2013, Serbia pranoi që të fillojë zbatimin e marrëveshjes së MIK-ut, vetëm pasi mori garancinë nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, z. Thaçi, se të hyrat doganore të mbledhura në pikat kufitare në veriun e vendit do të shfrytëzoheshin për zhvillimin e komunitetit lokal në veri të Kosovës. Në bazë të marrëveshjes së MIK, “të hyrat e mbledhura në PK veriore [pikat kufitare në Jarinje dhe Bërnjak] për produktet e importuara dhe të destinuara për veri do të shkojnë (përmes buxhetit shtetëror të Kosovës) në Fondin Zhvillimor për Veriun.” Gjersa Serbia përfitoi nga themelimi i Fondit Zhvillimor për Veriun, Republika e Kosovës përfitoi në kuptimin e vendosjes së zyrtarëve të Policisë së Kosovës dhe Doganave të Kosovës dhe kështu zgjeroi sovranitetin e saj në veri.¹⁹ Përkundër marrëveshjes së MIK, Serbia refuzoi të themelojë pikat kufitare të përhershme në territorin e saj. Autoritetet e Kosovës, si zakonisht e kanë respektuar marrëveshjen dhe kështu kanë ndërtuar dy pika kufitare të përhershme dhe kanë themeluar Fondin Zhvillimor për Veriun.

19. Vendimi i qeverisë së Kosovës i vitit 2011 mbi zbatimin e masave të reciprocitetit në raportet tregtare me Serbinë nuk pati thujtë fare ndikim në importet nga Serbia;

¹⁷ GPLS (2013), ‘Dialogu Kosovë-Serbi: Dritaret e Mundësisë apo një Shtëpi Kartash? Analiza e Politikave’. Në dispozicion në: <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2013/03/KOSOVO%E2%80%93SERBIA-DIALOGUE-Windows-of-Opportunity-or-a-House-of-Cards.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

¹⁸ Kursani dhe Thaçi (2015), ‘Rregullimi i tregtisë ndërmjet kufijve të kontestuar. Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros’. Në dispozicion në: https://www.international-alert.org/sites/default/files/Caucasus_RegulationOfTradeAcrossBorders_EN_2015.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

¹⁹ Phillips (2017), ‘Rishikimi i implementimit të dialogut Kosovë-Serbi’. Në dispozicion në: https://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

sipas të gjitha gjasave për shkak se ishte jetë-shkurtër. Me zgjidhjen politike të mosmarrëveshjes tregtare, në të njëjtin vit, importet nga Serbia vazhduan të rriten (Tabela 2). Edhe pse eksportet e Kosovës pothuajse u dyfishuan dhe kështu shënuan një vlerë prej 7 milion € në 2011, ato nuk arritën vlerën prej rreth 20 milion € që e kishin pasur para embargos së vitit 2008 të vendosur nga Serbia; eksporteve të Kosovës iu deshën tre vite për t'u rimëkëmbur dhe për të tejkaluar vlerën e vitit 2007. Përkundër rithemelimit të raporteve tregtare në mes të dy shteteve, edhe pse deficitit tregtar i Kosovës me Serbinë shënoi përmirësim, ai ende mbetet i lartë – eksportet e Kosovës mbulojnë vetëm rreth 10 përqind të importeve nga Serbia. Asimetria në raportet tregtare në një masë të madhe është rezultat i zbatimit të vazhdueshëm nga ana e Serbisë të pengesave jo-tarifore, pengesave teknike dhe masave/standardeve sanitare dhe fitosanitare ndaj eksporteve të Kosovës. Këto pengesa tregtare janë de facto të barasvlershme me embargo ndaj produkteve të Kosovës të eksportuara në Serbi apo/dhe në transit përgjatë Serbisë.

Tabela 2. Eksportet, Importet, Bilanci Tregtar dhe Raporti i Eksporteve ndaj Importeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, 2011-2018

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|--|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Importet (në mil €) | 254.9 | 278.4 | 285.4 | 368.2 | 382.1 | 387.6 | 449.9 | 388.9 |
| Eksportet (në mil €) | 7.2 | 15 | 14.5 | 27.3 | 32.3 | 41.3 | 48.2 | 33.5 |
| Bilanci tregtar (në mil €) | -247.7 | -263.4 | -270.9 | -340.9 | -349.8 | -346.3 | -401.7 | -355.4 |
| Raporti i eksporteve ndaj importeve (në %) | 2.82 | 5.39 | 5.08 | 7.41 | 8.45 | 10.66 | 10.71 | 8.61 |

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës (2018)

20. Një përfundim i rëndësishëm nga analiza e raporteve tregtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë është se përfituesi kryesor është Serbia. Që nga hyrja në fuqi e CEFTA-s në vitin 2007 deri në ndalimin nga ana e Serbisë e eksporteve të Kosovës, importet nga Serbia kanë shënuar një vlerë prej 3.7 miliardë €, përderisa eksportet e Kosovës kanë arritur vlerën prej vetëm 256 milionë € (d.m.th. eksportet e Kosovës mbulojnë më pak se 7 përqind të importeve nga Serbia). Për shkak të kësaj, Serbia ka përfituar fuqishëm nga CEFTA duke u shndërruar në importuesin kryesor të Kosovës. Në këtë drejtim, Serbia lë pas edhe Gjermaninë – shtetin kryesor pritës të

emigrantëve shqiptarë nga Kosova – importet nga i cili vend për të njëjtën periudhë arrijnë vlerën prej 3.4 miliardë €.²⁰

21. Në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, vendet arritën “Marrëveshjen e Fusnotës” për përfaqësimin dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat rajonale si Palë, me ç’rast UNMIK ose akterët tjerë ndërkombëtarë nuk do të vepronin në emër të Kosovës dhe nuk do të ishin prezentë. Kjo marrëveshje parasheh që Kosovës në vend të emrit të vet kushtetues do të emërtohet si Kosovo*, ku asteriksi përfaqëson fusnotën, e cila thotë: “ky emërtim [Kosovo*] nuk paragjykon qëndrimin mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe me Mendimin e GJND mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës”.²¹ Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, pas një beteje të madhe politike me Serbinë, në vitin 2014 Kosova u bë pjesëmarrëse e Procesit të Berlinit dhe anëtare e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR). Puna e KBR bazohet në Strategjinë e EJL 2020, e cila ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës në rajon dhe rifokusimin në konkurrueshmëri dhe zhvillim. Përkundër pritjeve të mëdha, Kosova nuk ka qenë në gjendje të shijojë dobitë e anëtarësimit në KBR, sepse, për shkak të lobimit të vazhdueshëm të Serbisë, Kosova ende nuk është pjesë e 14 iniciativave të KBR-së.²² Si përfundim, në bazë të kësaj marrëveshjeje, përpjekjet e Kosovës për përfaqësim dhe anëtarësim në iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare ishin kryesisht të pasuksesshme.²³

22. Në vitin 2013, Kosova dhe Serbia u pajtuan për “Marrëveshjen e Parë mbi Parimet që rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve”. Kjo marrëveshje u quajt edhe “Marrëveshja e Brukselit” dhe “ofroi rrugën drejt integritit Evropian edhe për

²⁰ Gashi dhe Berisha (2019), ‘Efekti i tarifës 100% në importin e mallrave nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina’. Në dispozicion në: https://www.researchgate.net/publication/333458356_The_Impact_of_100_Tariff_on_the_Import_of_Goods_from_Serbia_and_Bosnia_and_Herzegovina [Qasur më: 31 gusht 2019].

²¹ MSA Kosova (2016), ‘Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër’. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

²² KCSS (2014), ‘Anëtarësimi dhe Përfaqësimi i Kosovës në Iniciativat Rajonale të Sigurisë’. Në dispozicion në: http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo%E2%80%99s_Membership_and_Representation_in_Regional_Security_Initiatives_668693.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

²³ Po aty.

Kosovën edhe për Serbinë (19 prill 2013)".²⁴ Negociatat vazhduan pa ndonjë përparim serioz. Më 25 gusht 2015, Pakoja e Marrëveshjes së Brukselit u zhvillua, me qëllim të riinicimit të saj. Ndër të tjera, pakoja parashihte një marrëveshje për normalizimin e situatën në Mitrovicë dhe çmontimin e strukturave paralele.

23. Më 1 prill 2016, Kosova filloi marrëdhëniet e para kontraktuale me BE, duke miratuar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA).²⁵⁻²⁶ Marrëveshja parasheh qasje pa tarifa doganore në tregun e BE-së, si dhe asistencë teknike dhe financiare. Ky "proces do të çojë në përparimin e perspektivës evropiane të Kosovës dhe në rivendosjen e marrëdhënieve miqësore me BE-në".²⁷ Në këmbim, Kosova është përkushtuar "për zbatimin e MSA sipas Agjendës Evropiane për Reformë dhe për përforsimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe reformimin e ekonomisë".²⁸ Edhe Kosova edhe Serbia do të kontribuojnë në zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në bazë të MSA-ve të tyre të nënshkruara me BE-në. Sipas MSA-së, Kosova duhet të fokusohet në "zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë" (Neni 7). Ngjashëm, sipas Nenit 6 të MSA-së në mes të BE dhe Serbisë, "Serbia përkushtohet që të vazhdojë të kujdeset për bashkëpunimin rajonal dhe për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, duke përfshirë këtu një nivel të përshtatshëm të koncesioneve reciproke lidhur me

²⁴ Phillips (2017), 'Rishikim i implementimit të dialogut Kosovë-Serbi'. Në dispozicion në: https://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

²⁵ Pas Traktatit të Lisbonës, marrëveshja ishte nënshkruar nga BE në cilësinë e entitetit ligjor dhe kështu nuk kishte nevojë që e njëjta të ratifikohet shtetet anëtare të BE individualisht, prej të cilave pesë ende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.

²⁶ Komisioni Evropian (2016), Raporti i progresit të Kosovës* 2016'. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

²⁷ MSA Kosova (2016), 'Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër'. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

²⁸ Komisioni Evropian (2016), Raporti i progresit të Kosovës* 2016'. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

lëvizjen e njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve ...”²⁹ Gjithashtu, edhe Kosova edhe Serbia duhet të përkushtohen për normalizimin e marrëdhënieve midis tyre. Sipas Nenit 13 të MSA, “dialogu politik dhe dialogu mbi kursin e veprimit, sipas nevojave, duhet të kontribuojë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë”.³⁰ Sipas kapitullit 35, Serbisë nuk do t’i sigurohet anëtarësimi në BE derisa t’i normalizoj marrëdhëniet e saj me Kosovën.³¹ Në bazë të Këshillit të BE-së, “Serbia duhet të sigurohet se e ka kompletuar pjesën e saj të punës rreth zbatimit të marrëveshjeve të 25 gushtit 2015. Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë do të monitorojnë për së afërmi dhe vazhdimisht plotësimin nga ana e Serbisë të pjesës së parë të standardeve (caqeve) të përkohshme të përfshira në qëndrimin e përbashkët të BE-së dhe do t’i raportojnë së paku dy herë në vit, lidhur me këtë çështje, Këshillit”.³² Normalizimi i marrëdhënieve përfshinë edhe normalizimin e raporteve tregtare. Përkundër faktit që anëtarësimi i saj në BE është kushtëzuar me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, Serbia vazhdon të aplikojë pengesa jo-tarifore, pengesa teknike si dhe masa/standarde sanitare dhe fitosanitare ndaj eksporteve të Kosovës (shih Shtojca 1 në këtë punim).

Tarifa Doganore 100 % dhe Raportet Tregtare Bilaterale në mes të Kosovës dhe Serbisë 2019

24. Në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 8 nëntor 2018, u vendos një masë mbrojtëse/tarifë doganore prej 10% ndaj produkteve të

²⁹ MSA Serbia (2013), ‘Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare të saj në njërin anë, dhe Republikës së Serbisë, në anën tjetër’. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/serbia/key_document/saa_en.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

³⁰ MSA Kosova (2016), ‘Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër’. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf (Qasur më: 31 gusht 2019)

³¹ Bashkimi Evropian (2014), ‘Konferencë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian - Serbia. Dokumenti i pranimit’. Në dispozicion në: <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?!=EN&t=PDF&gc=true&sc=false&f=AD+1+2014+INIT> [Qasur më: 31 gusht 2019].

³² Këshilli i Bashkësisë Evropiane (2015), ‘Takimi i dytë i Konferencës së Aderimit me Serbinë në nivelin Ministror’. Në dispozicion në: <https://www.consilium.europa.eu/media/21901/press-release-accession-conference-with-serbia.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

importuara që vend të origjinës e kanë Serbinë ose BeH-në.³³ Produktet e brendeve/markave ndërkombëtare me origjinë nga këto dy vende u liruan nga kjo tarifë. Ky vendim erdhi si pasojë e pengesave të vazhdueshme ekonomike dhe politike që Serbia dhe BeH ia shkaktonte Republikës së Kosovës, si dhe si pasojë e shkeljes së marrëveshjeve të Dialogut të Brukselit nga ana e Serbisë, lidhur me normalizimin e raporteve. Siç u argumentua nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës Ramush Haradinaj, vendimi u nxit nga shkeljet e vazhdueshme të CEFTA-s dhe kryesisht pengesat jo-tarifore që këto dy vende i aplikuan ndaj eksportuesve të Kosovës, si dhe nga shkelja e drejtpërdrejt e sovranitetit të Kosovës. Pra, masa ishte edhe një kundërpërgjigje e drejtpërdrejt ndaj lobimeve të ngjeshura të Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe Interpol, dhe lobimeve për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë të shtetave, të cilat e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.³⁴

25. Pa marrë në konsideratë shkeljet e marrëveshjeve të arritura përmes Dialogut të Brukselit, shkeljet e vazhdueshme të sovranitetit të Kosovës dhe lobimit të vazhdueshëm kundër pavarësisë dhe anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, sidomos shkeljet e saj të vazhdueshme të CEFTA-s përmes aplikimit të pengesave tregtare ndaj eksportuesve të Kosovës, si dhe pa marrë për bazë Nenin 42, Paragrafi 3 i CEFTA mbi masat e reciprocitetit, Serbia pretendonte se Vendimi paraqiste shkelje të CEFTA-s dhe dëmtonte përpjekjet e bashkëpunimit rajonal për një Ballkan paqësor dhe prosperues, dhe se i njëjti vendim nuk paraqiste masa ribalancuese.

26. Për shkak të ngurrimit të Serbisë për të shfuqizuar pengesat tregtare, qeveria e Kosovës, më 21 nëntor 2018, mori një vendim të ri, me të cilin u shfuqizua vendimi i

³³ Qeveria e Kosovës (2018), Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/74'. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-74-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2018-1.pdf> [Qasur më: 31 gusht 2019].

³⁴ Në nëntor 2018, Kryeministri i KOSOVËS z. Haradinaj shpeshu zhgënjimin e thellë të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit kundër anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë.

datës 8 nëntor 2018.³⁵ Sipas vendimit të ri, tarifa doganore u rrit në 100%. Sërish, markat ndërkombëtare u liruan nga tarifa. Vendimi i ri parashihte që Doganat e Kosovës të ndalojnë importin e të gjitha produkteve, të cilat nuk i referoheshin Kosovës në emrin e saj kushtetues, dhe që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të urdhërojë dhe të inspektojë heqjen nga tregu të të gjitha këtyre produkteve. Po ashtu, Vendimi parashihte edhe reciprocitet të plotë lidhur me pengesat tregtare administrative të aplikuara nga Serbia. Ky Vendim u plotësua me Vendimin Nr. 06/82, i cili parashihte aplikimin e tarifës doganore edhe ndaj markave ndërkombëtare.³⁶

27. Sipas kryeministrit të dorëhequr të Kosovës, z. Haradinaj, vendimet ishin legjitime dhe kundërpërgjigje ndaj shkeljeve të vazhdueshme të CEFTA-s vetëm në raport me Kosovën nga ana e Serbisë, si rezultat i të cilave Kosova nuk ka mundur të shijojë përfitimet e anëtarësimit të saj në CEFTA, si dhe kundërpërgjigje ndaj aktiviteteve tjera të Serbisë kundër Republikës së Kosovës që paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare të vendit.³⁷ BE dhe komuniteti ndërkombëtar, në frymën e dialogut, lutën qeverinë e Kosovës që të anulojë vendimin ose, të paktën, ta suspendojë atë, në mënyrë që çështjet të adresohen dhe të zgjidhen përmes Dialogut të Brukselit.³⁸ Si rezultat i këtyre vendimeve, Serbia, duke mos marrë parasysh shkeljet e vazhdueshme të ekonomisë dhe sovranitetit të Kosovës, përsëriti se Vendimet paraqesin shkelje të CEFTA-s. Dialogu i Brukselit u ndërpre, për shkak se Serbia deklaroi se ajo nuk do të merrte pjesë në të derisa Kosova të shfuqizojë tarifën

³⁵ Qeveria e Kosovës (2018), Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/76'. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-76-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2018.pdf> pQasur më: 31 gusht 2019].

³⁶ Qeveria e Kosovës (2018), Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/82'. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/12/Vendimet-e-mbledhjes-82-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf> Qasur më: 31 gusht].

³⁷ Zyra e Kryeministrit (2018), 'Kryeministri Haradinaj: Masa prej 100 për qind ndaj Serbisë, shkak i bllokimit të vendit për t'i gëzuar të drejtat e CEFTA-s'. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/kryeministri-haradinaj-masa-prej-100-per-qind-ndaj-serbise-shkak-i-bllokimit-te-vendit-per-ti-gezuar-te-drejtat-e-cefta-s/> [Qasur më: 31 gusht 2019].

³⁸ Aksioni i Jashtëm i Bashkimit Evropian (2018), 'Vërejtje nga Znj. Mogherini në konferencën e përbashkët për shtyp pas Këshillit të 5-të të Stabilizim-Asociimit BE-Serbi'. Në dispozicion në: <https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/55703/remakosoves-hrvp-mogherini-joint-press-conference-folloeing-5th-eu-serbia-stabilisation-and-en> [Qasur më: 31 gusht 2019].

doganore 100% ndaj produkteve të Serbisë.³⁹ Z. Haradinaj, megjithatë, insistoi në qëndrimin se tarifa doganore 100% do të shfuqizohet vetëm kur Serbia ta njohë Kosovës si shtet të pavarur.⁴⁰ Qeveria e Kosovës e ka “zbutur paksa qëndrimin e saj, duke kërkuar tani një garancion ndërkombëtar që bisedimet të çojnë në njohje reciproke”.⁴¹

28. Sipas Gashi dhe Berisha⁴², aplikimi i tarifës doganore 100% ka shkaktuar zvogëlimin e vlerës dhe numrit të produkteve të importuara nga Serbia në thuajse zero. Siç shihet në Tabelën 3, vlera e importeve nga Serbia ka rënë për 98 përqind kur e krahasojmë tremujorin e parë të vitit 2018 me tremujorin e njëjtë të vitit 2019 (kur filloi aplikimi i tarifës doganore). Krahasimi në mes të këtyre dy tremujorëve në bazë të numrit të produkteve të importuara nga Serbia tregon se ai është zvogëluar për 1,239 që nënkupton një zvogëlim prej rreth 90 përqind. Për më shumë, analiza tregon se importet e Kosovës kanë marrë kahje tjetër; importet nga Serbia dhe BeH janë zëvendësuar me importet nga BE, me siguri për shkak të masave preferenciale në tregti me BE-në në kuadër të MSA-së.

³⁹ Parlamenti Evropian (2019), ‘Përmbledhje e Parlamentit Evropian. Marrëdhëniet Serbi-Kosovë. Ballafaqim ose Normalizim?’. Në dispozicion në: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI\(2019\)635512_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI(2019)635512_EN.pdf) [Qasur më: 31 gusht 2019].

⁴⁰Koha (2018), ‘Haradinaj: Taksa 100 për qind hiqet vetëm atëherë kur Serbia e njeh Kosovën’. Në dispozicion në: <https://www.koha.net/arberi/130390/haradinaj-taksa-100-per-qind-hiqet-vetem-atehere-kur-serbia-e-njeh-kosoven/> [Qasur më: 31 gusht 2019].

⁴¹ Parlamenti Evropian (2019), ‘Përmbledhje e Parlamentit Evropian. Marrëdhëniet Serbi-Kosovë. Ballafaqim ose Normalizim?’ Në dispozicion në: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI\(2019\)635512_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI(2019)635512_EN.pdf) [Qasur më: 31 gusht 2019].

⁴² Gashi dhe Berisha (2019), ‘Efekti i tarifës 100% në importin e mallrave nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina’. Në dispozicion në: https://www.researchgate.net/publication/333458356_The_Impact_of_100_Tariff_on_the_Import_of_Goods_from_Serbia_and_Bosnia_and_Herzegovina [Qasur më: 31 gusht 2019].

Tabela 3. Implikimet e tarifës doganore 100% në vlerën e importeve dhe numrin e produkteve të importuara nga Serbia

| Viti/muaji | 2018 | 2019 | | 2018 | 2019 | |
|-----------------|------------------------|------------------------|-----------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------------|
| Vlera/ndryshimi | Vlera (në mil €) | Vlera (në mil €) | Ndryshimi (në %) | Numri i produkteve | Numri I produkteve | Ndryshimi (në %) |
| Janar | 30.93 | 0.79 | -97.45 | 673 | 92 | -86.33 |
| Shkurt | 30.11 | 0.48 | -98.41 | 766 | 73 | -90.47 |
| Mars | 36.56 | 0.53 | -98.55 | 940 | 82 | -91.28 |
| Prill | 37.04 | 0.64 | -98.27 | | | |

29. Në analizën e tyre mbi ndikimin e tarifës doganore prej 100 përqind në çmimet në tregun e Kosovës, Gashi dhe Berisha⁴³ tregojnë se për karburantin diesel, benzinë, vajra për ngrohje, misër, miell dhe sheqer, raporti vlerë-peshë ka përcjellur çmimet globale për periudhën janar-mars 2019. Rrjedhimisht, nuk ka ndonjë “indikacion se tarifa ka shkaktuar ndonjë rritje në çmimet e këtyre produkteve.”

30. Në bazë të Pikave 28 dhe 29 të këtij punimi, ekonomia e Kosovës ka arritur që shumë shpejt të përshtatet ndaj situatës së re, duke zëvendësuar importet nga Serbia dhe BeH me importe nga BE për shkak të masave preferenciale në tregti me BE-në në kuadër të MSA-së. Po ashtu, nuk ka ndonjë indikacion se janë rritur çmimet në tregun e Kosovës si rezultat i aplikimit të tarifës doganore 100 përqind ndaj importeve nga Serbia dhe BeH. Për fund, përderisa ekziston një shpërndarje asimetrike e përfitimeve nga anëtarësimi në CEFTA në favor të Serbisë, asimetria në shpërndarjen e përfitimeve nga tarifa doganore prej 100 përqind, siç po vërehet, është në favor të ekonomisë së Kosovës. Rrjedhimisht, në një treg të hapur askush nuk është i pazëvendësueshëm, prandaj secili duhet të sillet në përputhje me rregullat e lojës (të miratuara/pranuara me marrëveshje).

⁴³ Gashi dhe Berisha (2019), ‘Ndikimi i tarifës 100% në importin e mallrave nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina’. Në dispozicion në: <https://www.researchgate.net/publication/333458356> The Impact of 100 Tariff on the Import of Goods from Serbia and Bosnia and Herzegovina [Qasur më: 31 gusht 2019].

Rekomandimet

Republika e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të shijojë dobitë nga të qenurit anëtare e CEFTA-s për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të marrëveshjes nga ana e Serbisë në raportet tregtare me Kosovën, si dhe për shkak se CEFTA-s i mungon një mekanizëm i pavarur, efektiv dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, vendimet e të cilit do të ishin ligjërish të obligueshme për Palët. Për të ndryshuar këtë situatë, rekomandimet për qeverinë e Kosovës të listuara mëposhtë do të fokusohen kryesisht në arritjen e një zgjidhje për mosmarrëveshjen tregtare dhe në kërkesën për të pasur një mekanizëm të pavarur, efektiv dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare.

1. Sipas kushtetutës së Kosovës, marrëveshjes për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe sipas Deklaratës së PSSP-së,⁴⁴ qeveria e Kosovës duhet të nënshkruaj CEFTA-n në emër të vetin dhe kështu të bëhet Nënshkruese dhe Palë në CEFTA me të drejta dhe detyrime të plota, sikur të gjitha Palët e tjera të CEFTA-s.
2. Sipas kushtetutës së Kosovës, marrëveshjes për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe sipas Deklaratës së PSSP-së⁴⁵, qeveria e Kosovës, në asnjë rrethanë, nuk duhet të pranojë që të përfaqësohet nga UNMIK-u në CEFTA apo në ndonjë marrëveshje tjetër rajonale dhe ndërkombëtare.
3. Qeveria e Kosovës duhet të marrë pjesë në të gjitha iniciativat e KBR. Në këtë drejtim, Serbia nuk duhet të pengojë Kosovën të marrë pjesë në çfarëdo initiative apo mekanizmi në kuadër të KBR-së.

⁴⁴ UNMIK (2006), 'Deklarata e Përfaqësuesit Special të Sekretarit Gjeneral të OKB mbi nënshkrimin e Amandamentimit dhe Anëtarësimin në CEFTA'. E qasshme në bazë të kërkesës.

⁴⁵ Po aty.

4. Qeveria e Kosovës duhet të kompletojë zbatimin e marrëveshjes së MIK-ut dhe të kërkojë nga Serbia që e njëjta të respektojë marrëveshjen në plotësi. Lidhur me këtë, një afat kohor duhet të përcaktohet me marrëveshje në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE.
5. Qeveria e Kosovës duhet të themelojë një grup punues teknik me ekspertizë në marrëdhëniet tregtare.
6. Qeveria e Kosovës duhet ta mandatojë këtë grup punues teknik që, në bazë të Databazës mbi Pengesat e Qasjes në Treg të CEFTA-s, ta përditësojë listën e pengesave jo-tarifore, pengesave teknike dhe masave/standardeve sanitare dhe fitosanitare të aplikuara nga Serbia ndaj eksportit dhe tranzitit të mallrave dhe shërbimeve kosovare (Shtojca 1 në këtë punim) dhe të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e Kosovës që nuk njihen nga autoritetet e Serbisë, si dhe të evidentojë të gjitha shkeljet tjera të CEFTA apo shkeljeve të marrëveshjeve tjera që përkufizojnë raportet tregtare në mes të Kosovës dhe Serbisë që nuk janë përfshirë në Shtojcën 1 në këtë punim.
7. Pas përditësimit të listës së pengesave tregtare (shif Rekomandimin nr. 6), qeveria e Kosovës duhet të kërkojë që ky grup punues teknik të bashkëpunojë ngushtë me një grup punues teknik të të njëjtit format të Serbisë, me qëllim që të identifikohen dhe të punohet rreth të gjitha mosmarrëveshjeve dhe të ofrohen rekomandime të detajuara mbi atë se si të njëjtat të zgjidhen në mënyrë efektive dhe efikase. Grupi punues teknik i Kosovës duhet të punojë edhe me listën e pengesave ekzistuese (shih Shtojcën 1 në këtë punim për detaje) dhe të pajtohen me grupin punues teknik nga Serbia që:
 - a. Serbia t'i pranojë të gjitha testet e realizuara nga laboratorët e Kosovës apo të vendeve tjera (në rast se kjo është situata) dhe që Serbia nuk do të kërkojë më që teste shtesë të realizohen në laboratorët e Serbisë për lëngjet, të cilat eksportohen nga Kosova në Serbi.

- b. Serbia t'i pranojë të gjitha dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës dhe se Serbia nuk do të kërkojë më që dokumentet të lëshohen edhe në gjuhën serbe.
- c. Serbia të arrijë një marrëveshje me Kosovën, në mënyrë që bizneset, të cilat merren me metale të vjetra dhe skrap nga metali, të lejohen të eksportojnë në Serbi dhe të shfrytëzojnë Serbinë si vend tranzit, derisa Kosova të bëhet nënshkruese e "Konventës së Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbeturinave të Rrezikshme dhe Hedhjes së tyre".
- d. Serbia duhet të përmbahet nga ndalimi në bazë të shpjegimeve të lira verbale (në bazë të diskrecionit të zyrtarëve shtetëror) i eksportit apo tranzitit të produkteve nga dhe/ose për në Kosovë, siç është rasti me ndalimin e eksportit Kosovar të drunjëve dekorativë.
- e. Serbia duhet të aplikojë standarde Evropiane lidhur me orarin e punës së zyrtarëve serbë për çështje fitosanitare në pikat kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.
- f. Serbia, sipas Marrëveshjes së Brukselit, nuk duhet të ndalojë, por duhet të lejojë eksportin dhe tranzitin e produkteve kosovare të cilat përmbajnë etiketën që tregon se produktet janë prodhuar në Kosovë, siç është rasti i verërave në shishe qelqi dhe produkteve nga plastika e ricikluar.
- g. Serbia duhet të njohë/ pranojë të gjitha certifikatat dhe dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës që përmbajnë shenja dalluese apo simbole të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Serbia duhet të pranojë certifikatat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës për materialet izoluese të përdorura në ndërtimtari. Po ashtu, Serbia duhet të pranojë vulat kombëtare të Kosovës dhe të mos e kushtëzojë eksportin, veçanërisht tranzitin e produkteve të importuara nga vendet e BE-së, me pasjen e çertifikatës së

ashtuquajtur EUR 1 dhe/apo me pasjen e certifikatës dhe dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e Serbisë.

- h. Serbia duhet të mundësojë regjistrimin e prodhuesve farmaceutikë dhe/apo prodhuesve tjerë, për të cilët për eksport sipas ligjeve të Serbisë kërkohet regjistrimi në autoritetet përkatëse të Serbisë.
 - i. Serbia duhet të mos i bllokojë, por t'u lëshojë licenca, sa herë që kërkohet, bizneseve të Serbisë të interesuara për të nënshkruar kontrata për importim nga bizneset e Kosovës, siç është rasti me letrën apo kartonin e përdorur.
 - j. Serbia, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE, duhet të pranojë tabelat e regjistrimit të automjeteve, në mënyrë që eksportuesit e Kosovës të mund të përdorin transportues lokalë kosovarë për eksport dhe tranzit të mallrave përmes Serbisë.
 - k. Serbia duhet të respektojë në plotëni CEFTA-n dhe MSA-n, si dhe të lejojë bizneset kosovare të aplikojnë në tendere të menaxhuara përmes prokurimit publik në Serbi.
 - l. Serbia duhet të përmbahet nga përsëritja e praktikave të saj të aplikimit **të kohë pas kohshëm** të pengesave tregtare ndaj transportimit të naftës dhe derivateve të naftës të importuara nga Serbia. Në këtë drejtim, Serbia duhet ta njohë/pranojë certifikatën ADR të lëshuar nga kompanitë e akredituara në Kosovë dhe/apo në Maqedoninë e Veriut.
8. Për ta bërë procesin më dinamik, Ministrat e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës dhe Serbisë duhet që sipas nevojës të marrin pjesë në takimet e grupeve teknike punuese. Pas përfundimit të punës së grupeve teknike punuese, të njëjtit duhet t'i raportojnë ministrive përkatëse. Këto të fundit duhet t'ia përcjellin rekomandimet

kryesuesve të ekipeve negociatore të Kosovës dhe Serbisë të cilët duhet të arrijnë marrëveshje mbi normalizimin e raporteve tregtare, sipas CEFTA-s dhe MSA-së.

- 9.** Për të siguruar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura mbi normalizimin e raporteve tregtare (siç kërkohet në Rekomandimin nr. 8), Kosovës duhet të kontribuojë në normalizimin e raporteve tregtare vetëm nëse (i) ndërmjetësuesi i BE-së është i mandatuar t'i raportojë BE-së mbi zbatimin e marrëveshjeve të arritura dhe nëse (ii) procesi është i kushtëzuar me marrjen e masave nga BE ndaj palës që i shkelë marrëveshjet.⁴⁶ Në rast të shkeljes së marrëveshjeve tregtare, BE duhet të ndërpres ndërmjetësimin dhe të ngrijë fondet IPA për dhe/apo të ngrijë negociatat për anëtarësim në BE të palës përgjegjëse për shkeljen.⁴⁷

- 10.** Për të siguruar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura mbi normalizimin e raporteve tregtare (siç kërkohet në Rekomandimin nr. 8), Kosova duhet të kërkojë nga BE që të themelojë një mekanizëm monitorues. Raporti mbi zbatimin e marrëveshjeve i hartuar nga ndërmjetësuesi i BE-së duhet të shërbejë si bazë për monitorim. Gjithashtu, raporti mbi zbatimin e marrëveshjeve duhet të jetë pjesë e raportit gjithëpërfshirës mbi zbatimin e marrëveshjeve që rrjedhin nga Dialogu i Brukselit. Ky i fundit duhet t'i dorëzohet edhe Komisionit për Siguri Politike të Këshillit të BE-së.

- 11.** Për të siguruar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura mbi normalizimin e raporteve tregtare (siç kërkohet në Rekomandimin nr. 8), Kosova duhet të kërkojë nga BE që të caktojë një afat kohor për arritjen si dhe për zbatimin në plotësi të marrëveshjeve mbi normalizimin e raporteve tregtare.

⁴⁶ Një rekomandim i ngjashëm është dhënë në Phillips (2017) lidhur me dialogun Kosovë-Serbi.

⁴⁷ Phillips (2017), 'Rishikim i implementimit të dialogut Kosovë-Serbi'. Në dispozicion në: https://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf [Qasur më: 31 gusht 2019].

12.Nëse Serbia pajtohet në parim me rekomandimet e lartshënuara lidhur me normalizimin e raporteve tregtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, qeveria e Kosovës duhet të konsiderojë që përkohësisht ta suspendojë tarifën doganore prej 100 përqind. Mirëpo, në bazë të Nenit 42, Paragrafi 3 i CEFTA, Kosova duhet të mbajë në fuqi **masat e përkohshme ribalancuese** “sipas kushteve dhe në pajtueshmëri me procedurat e specifikuar në Nenin 24”, derisa Serbia t’i shfuqizojë të gjitha pengesat tregtare, të cilësdo natyrë, që i ka aplikuar ndaj eksportit dhe tranzitit kosovar, brenda afatit të dakorduar për zbatimin e marrëveshjeve në kuadër të negociatave (siç kërkohet në Rekomandimin nr. 11). Gjithashtu, Serbia në këmbim të suspendimit të përkohshëm të tarifës doganore prej 100 përqind duhet të ndaloj menjëherë fushatën e saj të ‘çnjohjeve’ ndaj pavarësisë së Kosovës.

Shtojca

Shtojca 1. Barrierat Jo-Tarifore, Barrierat Teknike dhe Standardet/Masat Sanitare dhe Fitosanitare të Imponuara nga Serbia ndaj Republikës së Kosovës

Sipas një zyrtari relevant në MTI, Serbia në mënyrë të drejtpërdrejt ka shkelur dhe është duke shkelur CEFTA-n duke aplikuar pengesa jo-tarifore, pengesa teknike dhe masa/standarde sanitare dhe fitosanitare ndaj eksporteve dhe tranzitit nga Kosova:

1. Për pijet që eksportohen në Serbi, për çdo eksport autoritetet e Serbisë kërkojnë teste shtesë. Ata marrin mostra të produkteve dhe i dërgojnë të njëjtat në laboratorë në Serbi për teste shtesë. Përfundimi i këtyre testeve merr kohë shume të gjatë, sa që nganjëherë ngarkesat e mallrave mbahen për më shumë se 40 ditë në terminalët doganore para se të përfundohet zhdoganimi. Shpenzimet për testet laboratorike dhe shërbimet e terminaleve doganore ndikojnë negativisht në aftësinë konkurruese të bizneseve të Kosovës dhe kështu shumica e bizneseve të intervistuarra kanë ndërprerë eksportin e produkteve të tyre në Serbi pas përvojës së parë me autoritetet e Serbisë.
2. Autoritetet e Serbisë kërkojnë që dokumentet të përgatiten gjithmonë në gjuhën serbe.
3. Kompanive, të cilat mbledhin metale të vjetra dhe mbeturina të metaleve, nuk u lejohet t'i shesin këto produkte në Serbi apo të shfrytëzojnë Serbinë si vend tranzit. Sipas tyre, autoritetet e Serbisë u kanë thënë se eksportuesit e Kosovës nuk mund të eksportojnë në Serbi apo atë ta shfrytëzojnë si vend tranziti, pasi që Kosova nuk është nënshkruese e "Konventës së Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbeturinave të Rrezikshme dhe Hedhjen së tyre".

4. Eksporti i drunjëve dekorativë të prodhuar në Kosovë u refuzua nën arsyetimin verbal se drunjtë dekorativë nuk mund të eksportoreshin në Serbi.
5. Në pikat kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë, zyrtarët serbë për çështje fitosanitare punojnë me orar të shkurtuar. Pas orës 14:00, asnjë inspektor nuk është i pranishëm në pikat kufitare, gjë që i detyron bizneset e Kosovës të presin deri të nesërmen për inspektim.
6. Në Serbi, prodhuesit e verërave nuk mund të eksportojnë verërat në shishe qelqi, pasi që ato përmbajnë etiketën që tregon se produktet janë prodhuar në Kosovë. Këto biznese eksportojnë vetëm verë në cisterna pa etiketë.
7. Të gjitha certifikatat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës duhet të jenë neutrale ndaj statusit të Kosovës që nënkupton se ato nuk guxojnë të përmbajnë shenja dalluese apo simbole shtetërore të Kosovës.
8. Prodhuesit farmaceutikë të Kosovës nuk janë në gjendje të eksportojnë në Serbi, pasi që atyre u kërkohet të regjistrohen te autoritetet e Serbisë si eksportues nga Kosova. Mirëpo, regjistrimi i tyre nuk mund të miratohet nga autoritetet e Serbisë, meqë ato nuk i njohin/pranojnë dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës, nëse dokumentet nuk janë neutrale ndaj statusit (gjegjësisht nëse ato përmbajnë shenja dalluese apo simbole shtetërore të Republikës së Kosovës).
9. Prodhuesit e mallrave të plastikës së recikluar nuk lejohen të eksportojnë në Serbi, nëse në paketimin e produkteve të tyre shkruan se janë të prodhuara në Kosovë.
10. Serbia nuk i njeh certifikatat e cilësisë të lëshuara nga autoritetet e Kosovës për materialet izoluese që përdoren në ndërtimtari.
11. Bizneset e Kosovës nuk mund të eksportojnë në Serbi duke përdorur transportuesit vendorë, meqë Serbia nuk i njeh tabelat e regjistrimit të automjeteve të Kosovës.

12. Prodhuesve të Kosovës nuk u lejohej të aplikojnë në tenderët e menaxhuara nga prokurimi publik në Serbi.

13. Bizneseve, të cilat mbledhin letër apo karton të përdorur, nuk u lejohej të eksportojnë në Serbi, sepse kompanive importuese të Serbisë autoritetet e Serbisë nuk u lëshojnë licencë për import nga Kosova.

